



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

DHOMA E DYTE E GJYKATES KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:014148

Datë: 02.05.2024

Numri i dokumentit: 05647069

**K.Dh.Shk.II.nr.307/24**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së dytë**, gjyqtar Ramush Bardiqi, në çështjen juridike përmbartimore të kreditori Project Plus Sh.P.K. Deli, me seli në Prishtinë, e përfaqëson me autorizim Agron Krasniqi avokat nga Prishtina, kundër debitorit Hidroterm Sh.P.K., me seli në Suharekë, e përfaqësuar me autorizim Nadire Hoxha, avokate nga Suhareka, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë KPPP.nr.2445/22 të datës 16.10.2023, me datë 02.05.2024, mori këtë:

### **A K T V E N D I M**

REFUZOHET si e bazuar ankesa e debitorit Hidroterm Sh.P.K., me seli në Suharekë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë KPPP.nr.2445/22 të datës 16.10.2023, VËRTETOHET.

### **A r s y e t i m**

Gjykata Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.2445/22 të datës 16.10.2023, në pikën I të dispozitivit e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit, kundër urdhrin përmbartimor P.nr.869/20, të datës 22.12.2020, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Bardh Tasholli, me seli në Ferizaj, në pikën II të dispozitivit ka mbete në fuqi urdhrin përmbartimor P.nr.869/20, të datës 22.12.2020, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Bardh Tasholli, me seli në Ferizaj .

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitorit Hidroterm Sh.P.K., me seli në Suharekë, pa i përmendur shkaqet ankimore, me të cilën e ka kontestuar në tërësi aktvendimin e Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë KPPP.nr.2445/22 të datës 16.10.2023, me propozim që të aprovohet si e bazuar ankesa e debitorit, duke e shfuqizuar Urdhrin për Përmbartim P.nr.869/20, të datës 22.12.2020 si dhe të anulohet aktvendimi KPPP.nr.2445/22 të datës 16.10.2023, dhe të kthehet lënda në rivendosije.

Përgjigje në ankesa ka parashtuar kreditori, duke kundërshtuar pretendimet e debitorit dhe ka propozuar që të refuzohet ankesa e debitorit si e pa bazuar dhe të vërtetohet aktvendimi KPPP.nr.2445/22 të datës 16.10.2023.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale – Dhomat e shkallës së dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (LPP), si dhe në kuptim të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjeti se:

### **Ankesa e debitorit është e pabazuar.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori, ka paraqitur propozim për lejimin e përmbartimit, kundër debitorit, në bazë të dokumentit të besueshëm – Faturës për shumën e borxhit prej 47,669.00 €.

Përmbartuesi Privat Bardh Tasholli, me seli në Ferizaj, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka caktuar urdhrin P.nr.869/20, të datës 22.12.2020, duke lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm - Faturës Nr.10/2020/HT të datës 06.10.2020, me të cilin e ka urdhëruar debitorin, që të ia paguaj kreditorit në emër të borxhit të përcaktuar sipas faturës shumën prej 47,669.00 €, me kamatë ligjore prej 8%, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore në pajtim me Udhëzimin Administrativ UA-MD Nr.06/2014, nën kërcënimin të përmbartimit të dhunshëm dhe pasojave tjera ligjore, përmbushja e detyrimit të realizohet përmes bllokimit të llogarive bankare të debitorit dhe transferimin e tyre në llogarinë e kreditorit, sekuestrimin e letrave me vlerë, sekuestrimi, vlerësimi shënimi i përmbartimit në librin publik të paluajtshmërive, shitjen e sendeve dhe përmbushjen e detyrimit të kreditorit, të bëhet përmbartimi në pjesën e pasurisë së debitorit në shoqërinë tregtare, dorëzimi i sendeve të luajtshme dhe kreditori të fitoj të drejtën e pengun në sendet e luajtshme.

Gjykata Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.2445/22 të datës 16.10.2023, në pikën I të dispozitivit e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit, kundër urdhrin përmbartimor P.nr.869/20, të datës 22.12.2020, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Bardh Tasholli, me seli në Ferizaj, në pikën II të dispozitivit ka mbete në fuqi urdhrin përmbartimor P.nr.869/20, të datës 22.12.2020, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Bardh Tasholli, me seli në Ferizaj .

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka theksuar se në rastin konkret, propozimi për përmbartim i përmbanë të gjitha elementet e parapara nga nenin 29 par. 1 nën para. 1.3 të LPP-së ku përcakton se: *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm dhe dokument i besueshëm sipas këtij ligji është fatura”*, ndërsa neni 29 par. 3 të LPP-së thuhet se: *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitorit, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*. Sipas vlerësimit të gjykatës së shkallës së parë dokumenti -

Faturës Nr.10/2020/HT të datës 06.10.2020, në shumë prej 47,669.00 euro, në bazë të së cilës është lejuar propozimi për përmbaerim, i plotësojnë kushtet ligjore për të qenë dokument të besueshme, për faktin se fatura në rastin konkret është e lëshuar në mënyrë të rregullt nga ana e kreditorit dhe është pranuar nga debitori flet kthesa e postes me dt. 25.11.2020 fakt ky qe vërtetohet nga flet kthesa e postes e cila gjendet ne shkresa te lendes dhe ne te cilën flet kthesë është specifikuar se njëjta përmban faturën mbi bazën e te cilës është lejuar Urdhri, ndërsa debitor i e ka pranuar faturën me përmbajtjen te faturës duke mos paraqitur kundërshtimin ndaj faturës. Andaj si e tillë i plotëson kushtet edhe nga neni 37 të LPP-së ku përcakton se : *“Kur propozimi për përmbaerim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit “* dhe këtë rast i propozimi është bashkëngjitur në origjinal. Andaj, edhe duke qenë së debitori e ka pranuar në mënyrë të rregullt faturën e po ashtu fatura përmban edhe kohën e përmbushjes së detyrimit monetar, si e tillë e njëjta mund të shërbej si dokument i besueshëm dhe ka tipare të përmbaerueshmërisë. Prandaj, Mbi këtë bazë ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi të atakuar.

Vlerësimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Dytë, e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë, në bazë të nenit 194 të LPK-së, i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbaerimore me rastin e vendosjes për refuzimin të prapësimit të debitorit. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, Dhomat e Shkallës së Parë drejtë kanë vlerësuar gjendjen faktike kur kanë konstatuar se fatura e lëshuar nga ana e kreditorit përmbajnë nënshkrim nga debitori, dhe përcakton kohën e përmbushjes. Në këtë drejtim gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar kushtet ligjore nga Neni 29 i LPP, i cili përcakton se *“Dokumentit të besueshëm është i përshatshëm për përmbaerim po qe se ne të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes se detyrimit monetar”*, ndërsa sipas nenit 37 të LPP-së ka përcaktuar se : *“Kur propozimi për përmbaerim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit“*. Prandaj, në këtë rast faturat mbi të cilat është lejuar urdhrin përmbaerimore i përmbajnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm në kuptim të nenit 29 par.3 të LPP-së, me arsyetimin së secila prej faturave janë treguar palët , përkatësisht kreditori dhe debitorit, si dhe në fatura në fjale është e emërtuara mallrat me të cilat është shërbyer debitori , po ashtu është përcaktuar shuma e cila është detyruar për përmbushjen nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së detyrimit.

Mbi bazën e kësaj dispozite ligjore, kjo Gjykatë vlerëson se dhomat e shkallës së parë kanë konstatuar drejtë se faturat si dokument i besueshëm mbi të cilën ishte iniciuar procedura

përmbartimore, respektivisht është lejuar përmbartimi i plotëson kushtet në mënyrë kumulative që duhet t'i ketë dokumenti i besueshëm. Në rastin konkret qartë rezulton se fatura nga debitori sipas flet kthesa e postes me dt. 25.11.2020 fakt ky e cila gjendet ne shkresa te lendes dhe ne te cilën flet kthesë është specifikuar se njëjta përmban faturën mbi bazën e te cilës është lejuar Urdhri, ndërsa debitor i e ka pranuar faturën me përmbajtjen te faturës duke mos paraqitur kundërshtimin ndaj faturës dhe si e tille është dokumenti i besueshëm dhe fiton tipare të përmbartueshmërisë së titullit ekzekutiv, mbi bazën e së cilës mund të konstatohet ekzistimi i detyrimit dhe pranimi si i tillë nga debitori. Së këndejmi, Gjykata thekson se me plotësimin e këtij kushti dokumenti i besueshëm mund ta ketë fuqinë e titullit përmbartues sepse rezulton se debitori e ka pranuar detyrimin, prandaj dhe dokumentet e besueshme në raport me dokumentet tjera përmbartimore duhet ta kenë fuqinë e pa kontestuar ekzekutive në mënyrë që procedura përmbartimore të iniciohet përmes këtyre dokumenteve. Një veprim i tillë, për Gjykatën paraqet pranim të faturës dhe detyrimit.

Së këndejmi, edhe gjykata e shkallës së dytë është e qëndrimit të njëjtë juridik se në procedurën përmbartimore organi përmbartues, përfshirë këtu edhe gjykatën që ka kompetencë shqyrtimin e ligjshmërisë së përmbartimit, nuk ka tagër të vlerësojë ligjshmërinë e raportit juridik nga i cili rrjedh dokumenti i besueshëm, statusin e palëve apo detyrimet e ndërsjella mes tyre. Por, organi përmbartues, përfshirë edhe gjykatën e shkallës së parë shqyrton vetëm rregullsinë dhe përshtatshmërinë e dokumentit përmbartues dhe/apo atij të besueshëm, me ç'rast procedura sipas prapësimi i nënshtrohet vetëm shqyrtimit formal të titullit ekzekutiv.

Kjo Gjykate , i vlerësoi edhe pretendimet e palës debitorë, mirëpo të njëjtat i vlerësoi si të pabazuara, për arsye se faturat mbi bazën e të cilave është lejuar urdhrin përmbartimor janë dorëzuar me rregull nga ana e kreditorit, ndërsa të njëjtat mbajnë nënshkrimin e debitorit.

Andaj, duke marr parasysh pretendimet ankimore, të cilat konsistojnë ndaj aktvendimit të ankimuar, Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhoma e Shkallës së Dytë konsideron se këto pretendimet ankimore janë të pa bazuara, ngase nuk kemi të bëjmë me shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore, dhe zbatimin të gabuar të drejtës materiale, të cilat shkelje kjo gjykatë i vështron sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, dhe as të Ligjit të Procedurës Përmbartimore.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 209 pika b) të LPK-së.

## **GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË**

**Dhoma e shkallës së dytë**

**K.Dh.Shk.II.nr.307/24 dt.02.05.2024**

**Gjyqtar,  
Ramush Bardiqi**